
بسم الله الرحمن الرحيم

NGA THELLËSITË E NAMAZIT

Imam Sejid Ali Khamenei (Allahu e mëshiroftë!)

Tiranë, 2026

Titulli: **Nga thellësitë e namazit**

Autori: ***Imam Sejid Ali Khamenei (Allahu e mëshiroftë!)***

Përgatitur nga: **Qendra Botërore e Informacionit e Ehli Bejtit / Kum**

E përktheu nga arabishtja: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Sonila QAZIMI**

E korrektoi: **Ma. Isra MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "Flladi" - Tiranë, 2026**

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirëshmit, Mëshirëplotit

Namazi dhe përgjërimi janë lidhja e ngushtë ndërmjet njeriut dhe Zotit të tij, ndërmjet krijesës dhe Krijuesit të saj. Namazi qetëson dhe u sjell prehje zemrave të trazuara e të lodhura. Ai pastron brendësinë dhe ndriçon shpirtin e njeriut. Ai është nxitësi dhe besëlidhja për lëvizje e përgatitje të vërtetë, larg shtirjes dhe mashtrimit, për t'u çliruar nga çdo e keqe dhe e ulët, si dhe për t'u pajisur me çdo gjë të mirë e të bukur. Namazi është një program për ta gjetur vetveten, e më pas për ta formuar dhe edukuar atë. Me pak fjalë, namazi është një lidhje dhe një rrjedhë e pandërprerë me burimin dhe shfaqjen e çdo bukurie: me Allahun.

Pse namazi konsiderohet më i rëndësishmi dhe më i vlefshmi ndër të gjitha detyrimet fetare dhe quhet themeli dhe shtylla e fesë? Pse, pa të, nuk pranohen veprat e tjera? Cili është sekreti i jashtëzakonshëm që fshihet në të?

Namazin mund ta shohim nga këndvështrime të ndryshme.

Së pari: Duhet të ndalemi te qëllimi i krijimit të njeriut, një prej parimeve themelore të botëkuptimit islam. Fakti që njeriu është krijesë dhe besimi në ekzistencën e një Fuqie të Urtë që e ka krijuar, nënkuptojnë domosdoshmërisht se krijimi i tij ka një qëllim.

Këtë qëllim mund ta krahasojmë me një udhëtim të planifikuar me kujdes, drejt një destinacioni të caktuar, me mjete të përcaktuara për të arritur atje. Në këtë rast, është e domosdoshme të njohim rrugën që na çon drejt qëllimit, të përcaktojmë drejtimin e udhëtimit dhe ta mbajmë gjithmonë parasysh synimin tonë, në mënyrë që të arrijmë rezultatin e dëshiruar.

Ai që hedh hapat në këtë rrugë nuk duhet të lejojë që shtigjet e gabuara dhe veprimet që e largojnë nga drejtimi i duhur ta shpërqendrojnë. Për të ruajtur orientimin e saktë, ai duhet të ndjekë udhëzimet e udhëheqësit dhe udhërrëfyesit (Profetit), i cili është caktuar për t'i treguar rrugën.

Ai qëllim është lartësimi dhe përsosja e pakufishme e njeriut, kthimi tek Allahu, shfaqja e virtyteve të larta në qenien e tij, çlirimi i energjive dhe aftësive të fshehura që ai zotëron, si dhe vënia e të gjitha këtyre në shërbim të përmirësimit të vetes, të botës dhe të njerëzimit. Prandaj, njeriu duhet ta njohë Allahun dhe të ecë në rrugën që Ai ka përcaktuar për ngritjen dhe përsosjen e tij, pa asnjë vonesë apo hezitim.

Ajo që i jep kuptim jetës së njeriut është kryerja e veprave që e afrojnë me qëllimin e tij dhe largimi nga gjithçka që e dëmton ose e pengon në arritjen e këtij qëllimi. Kjo është filozofia e jetës; pa të, jeta bëhet e zbrazët dhe e pakuptimtë.

Me fjalë të tjera, jeta është një shkollë dhe një laborator ku duhet të zbatojmë të gjitha ligjet dhe parimet e vendosura nga Krijuesi i botës dhe i jetës, në mënyrë që të arrijmë rezultate të larta e të kënaqshme. Këto ligje, që përbëjnë traditat dhe rregullat hyjnore të krijimit, duhet t'i njohim dhe ta ndërtojmë jetën tonë në përputhje me to. Po ashtu, duhet të njohim vetveten, të zbulojmë thesaret e fshehura brenda nesh dhe të kuptojmë nevojat e shpirtit tonë. Kjo është përgjegjësia dhe detyra e madhe e njeriut. Vetëm duke e përmbushur këtë detyrë, ai mund të ecë me vetëdije dhe sukses në rrugën e jetës. Në të kundërt, ose nuk do të mund të ecë përpara, ose do të lëvizë pa vetëdije, pa arritur suksesin e vërtetë.

Feja, duke përcaktuar qëllimin, drejtimin, rrugën dhe mjetet, i jep njeriut edhe forcën dhe furnizimin e nevojshëm për ta përshkuar këtë rrugë. Ndër furnizimet më të rëndësishme të udhëtarëve të kësaj rruge është përmendja e Allahut (dhikri). Fryma e kërkimit, e shpresës dhe e qetësisë, që së bashku përbëjnë krahët e këtij fluturimi shpirtëror, buron nga përmendja e Allahut. Kjo përmendje ia mban njeriut vazhdimisht para syve qëllimin e jetës: lidhjen me Allahun, burimin e çdo përsosmërie dhe bukurie. Ajo e pengon të humbasë rrugën, e ndihmon të jetë i vetëdijshëm dhe i kujdesshëm në zgjedhjen e metodave dhe mjeteve që përdor, i jep zemrës forcë, qetësi e gjallëri dhe e mbron nga rrëshqitjet, nga joshja e pamjeve tërheqëse të kësaj bote dhe nga frika përballë vështirësive e pengesave.

Shoqëria islame, çdo grup apo individ mysliman, mund të ecë me qëndrueshmëri në rrugën që Islami ka përcaktuar dhe drejt së cilës kanë thirrur të gjithë profetët, pa u ndalur e pa u kthyer prapa, për sa kohë që nuk e harron Allahun. Për këtë arsye, feja përpiqet me të gjitha mjetet dhe mënyrat që ta mbajë gjithmonë të gjallë përmendjen e Allahut në zemrat e besimtarëve.

Një nga veprat më të rëndësishme që e nxit njeriun të përmendë Allahun, e zhyt në kujtimin e Tij, e zgjon nga pakujdesia, i shërben si shenjë dhe udhërrëfyes në rrugën e drejtë, e ruan nga humbja dhe devijimi dhe nuk lejon që ai të bjerë në gaflet, qoftë edhe për një çast, është namazi.

Mes angazhimeve të shumta dhe shqetësimeve që i rëndojnë mendjen, njeriu rrallëherë ndalet të mendojë për vetveten, për qëllimin e jetës së tij apo për kalimin e orëve dhe ditëve. Sa e sa ditë ia lënë vendin natës e më pas ditëve të tjera, që kalojnë me shpejtësi! Sa javë e muaj kalojnë pa e kuptuar njeriu se kur fillojnë e kur mbarojnë, pa e ndier rrjedhën e jetës dhe pa reflektuar mbi kuptimin apo kotësinë e saj!

Namazi është si një kambanë zgjimi dhe një kujtesë që përsëritet në orë të ndryshme të ditës e të natës. Ai i jep njeriut një program të rregullt dhe kërkon prej tij përkushtim. I jep kuptim ditës dhe natës së tij dhe e bën të ndiejë vlerën e kohës.

Namazi e thërret njeriun pikërisht në ato çaste kur ai është i zhytur në angazhimet e tij dhe nuk e vëren kalimin e kohës e shterimin e jetës. Ai ia kujton përfundimin e një dite dhe fillimin e një tjetre, duke e nxitur të jetë më i zellshëm, të marrë përsipër më shumë përgjegjësi dhe të përqendrohet tek ajo që është më e rëndësishme.

Një pjesë e jetës ka kaluar pa u shfrytëzuar siç duhet. Prandaj, njeriu duhet të përpiqet më shumë dhe të japë më tepër nga vetja, sepse qëllimi që synon është madhështor. Duhet të përpiqemi ta arrijmë atë përpara se të jetë tepër vonë.

Nga njëra anë, është e natyrshme që njeriu, nën trysninë e angazhimeve dhe shqetësimeve materiale, ta harrojë qëllimin e jetës së tij. Nga ana tjetër, përmbushja e të gjitha përgjegjësive që i janë ngarkuar në rrugën drejt këtij qëllimi, çdo ditë e në çdo çast, është pothuajse e pamundur. Kjo bëhet edhe më e vështirë për atë që është i zhytur në punën dhe angazhimet e tij profesionale.

Për më tepër, njeriu nuk ka kurrë kohë të mjaftueshme për të përvetësuar, brenda një dite e një nate, të gjitha kërkesat, mësimet dhe konceptet e mesazhit islam, mbi të cilat ndërtohen jeta dhe lumturia e tij. Një gjë e tillë është praktikisht e pamundur.

Namazi përmbledh thelbin e parimeve të kësaj bindjeje dhe besimi. Fjalët dhe lëvizjet e tij të harmonizuara e të organizuara janë një shenjë dalluese e Islamit.

Namazin mund ta krahasojmë me himnin kombëtar të një shteti, megjithëse mes tyre ekziston një dallim i madh për sa i përket përmbajtjes dhe natyrës së ndikimit. Për të rrënjosur në mendjen e popullit parimet dhe bindjet e tij themelore, si dhe për ta edukuar atë sipas një mënyre të caktuar të menduari, shteti e përsërit vazhdimisht himnin kombëtar, i cili shpreh shkurtimisht mënyrën e jetesës dhe synimet që ai i konsideron të pranueshme e të dëshirueshme.

Përsëritja e himnit kombëtar ndihmon në rrënjosjen e këtyre ideve në mendjen e njerëzve dhe u kujton vazhdimisht se janë bij të atij atdheu dhe se ecin drejt synimeve të tij. Kjo sepse harrimi i parimeve dhe objektivave të shtetit nënkupton ndryshimin e drejtimit dhe shmangien nga rruga e përcaktuar prej tij.

Kjo përsëritje i përgatit njerëzit për t'i shërbyer asaj kauze, i njeh me planet dhe mënyrat e veprimit, i udhëzon në përmbushjen e përgjegjësive dhe detyrave të tyre, u rikujton parimet themelore mbi të cilat mbështetet shteti, u përcakton detyrat dhe, në fund, i pajis me guxim, vendosmëri dhe gatishmëri për veprim.

Po kështu, namazi përmbledh parimet themelore të besimit islam. Ai ndriçon rrugën e myslimanëve dhe i udhëzon ata drejt njohjes së përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre, rrugëve që duhet të ndjekin dhe rezultateve që duhet të synojnë.

Namazi është një thirrje që i drejtohet myslimanit në fillim të ditës, gjatë saj dhe në mbrëmje. Me gjuhën e vet, ai ia mëson dhe ia rikujton parimet themelore të besimit, rrugën që duhet të ndjekë, qëllimin që duhet të arrijë dhe përfundimin drejt të cilit synon, duke e nxitur të veprojë me forcë shpirtërore.

Ky është namazi. Ai e udhëheq njeriun hap pas hapi, shkallë pas shkalle, derisa e ngjit në majat e besimit dhe të veprës së përsosur, duke e shndërruar në një njeri me vlera të larta dhe në një mysliman të drejtë e të ekuilibruar.

Vërtet, namazi është Miraxhi (ngjitja shpirtërore) i besimtarit

Përpara njeriut shtrihet një rrugë e gjatë dhe e vështirë, e cila e udhëheq drejt së vërtetës dhe drejtësisë, duke e afruar me qëllimin për të cilin është krijuar. Mirëpo, kjo nuk është e vetmja rrugë që shtrihet përpara tij. Ka edhe shumë shtigje të shtrembëra, devijuese e të rrezikshme, që kryqëzohen me rrugën kryesore. Nganjëherë, këto shtigje

janë aq joshëse, saqë e hutojnë udhëtarin dhe ia vështirësojnë dallimin e rrugës së drejtë.

Prandaj, për të dalë nga ky hutim, duhet të ruajmë drejtimin e duhur drejt qëllimit përfundimtar, pra drejt Allahut, dhe të kemi një hartë të qartë të rrugës që duhet të ndjekim. Namazi nuk është gjë tjetër veçse një udhërrëfyes i përhershëm drejt Allahut dhe një hartë e përgjithshme e rrugës kryesore.

Kështu, namazi është garancia e lidhjes së vazhdueshme dhe e komunikimit të pandërprerë të besimtarit me Allahun. Në të është përfshirë, në mënyrë të përmbledhur, mendimi islam.

Në këtë mënyrë, bëhet e qartë arsyeja përse namazi është caktuar në pesë kohë gjatë ditës dhe natës, si dhe rëndësia e kësaj ndarjeje. Kjo mund të krahasohet me shpërndarjen e vakteve ushqimore në kohë të ndryshme të ditës dhe natës.

Përveç faktit se namazi përmban përmbledhjen e synimeve dhe idealeve të Islamit, në të është obligim edhe leximi i Kur'anit. Kjo sepse Kur'ani e njeh falësin me një pjesë të mësimeve të tij, e mëson të mendojë mbi konceptet kur'anore dhe e lidh vazhdimisht me Kur'anin në aspektin intelektual.[1]

[1] Njerëzit janë urdhëruar të falin namazin dhe të lexojnë Kur'an në të, që Kur'ani të mos mbetet i braktisur e i lënë pas dore, por të jetë

Në thelb, namazi, përmes lëvizjeve, fjalëve dhe veprimeve të tij, është një pasqyrim në miniaturë i Islamit në praktikë. Islami e nxit trupin, mendjen dhe shpirtin e njeriut drejt veprimit, duke i vënë të tria në shërbim të lumturisë dhe përsosjes së tij. Edhe namazi vepron në të njëjtën mënyrë, pasi gjatë faljes së tij trupi, mendja dhe shpirti i njeriut angazhohen njëkohësisht.

Trupi angazhohet përmes lëvizjeve të duarve, këmbëve dhe gjuhës, si dhe përmes përkuljes në ruku, uljes dhe sexhdes.

Mendja angazhohet përmes meditimit mbi kuptimin e fjalëve të namazit, të cilat, në përgjithësi, shprehin qëllimet, mjetet dhe rrugën që duhet ndjekur. Në këtë mënyrë, njeriu përshkon një cikël të shkurtër reflektimi mbi parimet e botëkuptimit islam.

Shpirti angazhohet përmes përmendjes së Allahut, fluturimit në hapësirën e vlerave shpirtërore, çlirimit të zemrës nga kotësitë dhe zbrazëtia, si dhe mbjelljes në shpirt të farës së përulësisë dhe frikës së shenjtë ndaj Allahut.

Është thënë se namazi i çdo feje përmbledh thelbin e asaj feje dhe namazi në Islam është vërtet i tillë. Bashkimi i shpirtit me trupin, i materies me kuptimin dhe i kësaj bote

vazhdimisht i studiuar dhe i përmendur, në mënyrë që të mos humbasë e të mos harrohet." (Nga hadithi i Fadl ibn Shadhanit, transmetuar nga imam Ali ibn Musa Err-Rrida (Paqja qoftë mbi të!).

me Botën Tjetër, i shprehur përmes fjalëve, përmbajtjes dhe lëvizjeve të namazit, përbën një nga veçoritë dalluese të tij në Islam.

Po kështu, myslimani që e fal namazin siç duhet dhe në mënyrë të plotë, i vë të gjitha energjitë dhe aftësitë e tij në shërbim të ngritjes dhe përsosjes së vet. Për të arritur këtë qëllim të lartë, ai vë njëkohësisht në veprim të gjitha potencialet e tij fizike, mendore dhe shpirtërore.

Namazfalësi, ashtu siç i përdor të gjitha forcat e tij për të gjetur rrugën drejt Allahut, po ashtu i shuan dhe i dobëson brenda vetes të gjitha shtysat e së keqes, të prishjes dhe të rënies morale.

Në disa ajete të Kur'anit, falja e namazit është përmendur si një nga shenjat e besimit dhe përkushtimit fetar, dhe në shumicën e këtyre ajeteve është përdorur shprehja "ikametu es-salah", vendosja dhe mbajtja e namazit.

Duket se "falja e namazit" është diçka më e gjerë sesa thjesht kryerja e tij. Pra, nuk mjafton vetëm që njeriu ta falë namazin dhe ta përmbushë detyrën e tij, por duhet edhe të ecë në drejtimin dhe rrugën drejt së cilës e thërret namazi, si dhe t'i nxisë të tjerët drejt saj. Është thënë se vendosja dhe mbajtja e namazit (*ikametu es-salah*) nënkupton që namazfalësi dhe njerëzit përreth tij të jetojnë në atmosferën shpirtërore të atyre që falen, domethënë të atyre që kërkojnë

afrimin me Allahun dhe adhurimin e Tij. Të gjithë duhet të jetojnë në përputhje me rrugën dhe orientimin që përcakton namazi.

Besimtari dhe shoqëria besimtare, përmes faljes së namazit, djegin rrënjët e degjenerimit, mëkateve dhe korrupsionit brenda vetes dhe në mjedisin shoqëror. Ata shuajnë prirjet drejt mëkatit, si dhe shkaqet e tij të brendshme e të jashtme, qofshin ato psikologjike apo mjedisore. Vërtet, namazi ngrihet si një pengesë ndërmjet individit dhe shoqërisë, nga njëra anë, dhe veprave të shëmtuara e të liga, nga ana tjetër:

﴿إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَى عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنكَرِ﴾

"Me të vërtetë, namazi ndalon nga imoraliteti dhe e keqja."[2]

Në fushën e konflikteve dhe përplasjeve të jetës, ku të gjitha forcat e së keqes janë mobilizuar me kurthe e mashtrime të çdo lloji për të zhdukur prirjet drejt mirësisë dhe bamirësisë kudo dhe te çdo njeri, pengesa e parë që i ndal dhe i zmbraps këto sulme është forca e vendosmërisë dhe qëndrueshmëria shpirtërore e njeriut. Sapo të shembet kjo fortesë e pathyeshme, bëhet më i lehtë pushtimi i kështjellës së personalitetit njerëzor dhe grabitja e thesareve

[2] Sure "El-Ankebut", ajeti 45.

që ruajnë origjinalitetin e tij, si dhe e rezervave të vlerave, njohurive dhe diturisë që zotëron.

Ata që mbartin një thirrje të re dhe plane madhështore për kohën dhe historinë, janë më të ekspozuar se të tjerët ndaj sulmeve të forcave të së keqes. Prandaj, ata kanë më shumë nevojë se kushdo tjetër ta ruajnë këtë fortesë çeliku: fortesën e vendosmërisë dhe vullnetit të pamposhtur.

Namazi në Islam, përmes përmendjes së vazhdueshme të Allahut, e lidh njeriun e dobët dhe të kufizuar me Allahun e Plotfuqishëm, Sunduesin Absolut, duke e nxitur të kërkojë ndihmë prej Tij. Përmes kësaj lidhjeje me Rregulluesin e universit, njeriu fiton një forcë të pakufishme dhe të pashtershme. Prandaj, namazi duhet të konsiderohet ilaçi më i mirë për dobësinë e njeriut dhe kura më e dobishme për forcimin e vendosmërisë dhe të vullnetit.

I Dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ndiente peshën e rëndë të përgjegjësisë për të sjellë ndryshimin e madh islam përballë injorancës së përhapur (xhahilijetit), u urdhërua të falte namaz gjatë natës:

﴿يَا أَيُّهَا الْمُزَّمِّلُ * قُمِ اللَّيْلَ إِلَّا قَلِيلًا * نِصْفَهُ أَوِ انقُصْ مِنْهُ قَلِيلًا * أَوْ زِدْ عَلَيْهِ وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا * إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا﴾

“O ti i mbuluar! Ngrihu natën për adhurim, përveç një pjese të vogël të saj. Gjysmën e natës, ose pak më pak se

ajo, ose shto pak mbi të dhe lexoje Kur'anin me lexim të qartë e të rregullt. Vërtet, Ne do të të ngarkojmë me një fjalë të rëndë."[3]

Tani do të kalojmë në shpjegimin e përmbajtjes së namazit. Pa u larguar nga kuptimi i tij i gjerë, do të përpiqemi t'i afrohemi qëllimit edukativ të namazit.

Namazi fillon me përmendjen e emrit të Allahut, të madhështisë së Tij dhe të pafundësisë së Qenies së Tij, duke theksuar se Ai është më i lartë dhe më madhështor se gjithçka që mendja e njeriut mund të përfytyrojë.

Namazfalësi e fillon bisedën dhe lutjen e tij me Allahun me këtë fjali. Për të hyrë në një vepër madhështore, vendoset një hyrje e mbushur me madhështi. Në namaz hyhet me thënien: Allahu Ekber *(Allahu është më i Madhi).*

Allahu është më i madh se çdo përshkrim, më i madh se çdo Zot i rremë që njerëzit kanë adhuruar gjatë shekujve; më i madh se të gjitha fuqitë dhe pushtetet prej të cilave njeriu mund të ketë frikë ose tek të cilat mund të mbështesë shpresat e tij; më i madh se çdo përpjekje për t'i kundërshtuar ose për t'i rrëzuar ligjet e Tij.

Kur robi i kupton këto të vërteta dhe zgjedh rrugën e përpjekjes dhe të veprimit të tij në dritën e tyre, çfarë force të jashtëzakonshme fiton duke kujtuar se "Allahu është më

[3] Sure "El-Muzzemmil", ajetet 1–5.

i Madhi"! Çfarë shprese e madhe ia mbush zemrën! Ai e ndien plotësisht se përpjekjet e tij janë të drejta dhe të bekuara, se përfundimi i punës së tij do të jetë i mirë, dhe e sheh të ardhmen dhe rrugën e tij me gëzim e shpresë.

Pas shqiptimit të kësaj thënieje, namazfalësi hyn praktikisht në gjendjen e namazit. Duke qëndruar në këmbë, ai duhet të lexojë suren "El-Fatiha" dhe më pas një sure të plotë nga Kur'ani.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

"Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit."

Kjo fjali është çelësi i të gjitha sureve, çelësi i namazit dhe çelësi i të gjitha veprave dhe lëvizjeve të myslimanit. Çdo punë fillon vetëm në emër të Allahut.

Gjithçka që njeriu zotëron dhe të gjitha shfaqjet e jetës së tij janë të lidhura me emrin e Allahut. Myslimani e fillon ditën e tij me emrin e Allahut dhe po me emrin e Tij e përfundon përpjekjen e ditës. Me përmendjen e Tij shkon në shtrat dhe me ndihmën e Tij ngrihet prej tij për të rifilluar detyrat e përditshme.

Në fund, ai largohet nga kjo botë me emrin dhe përmendjen e Allahut, për të hyrë në jetën e përhershme të Botës së Amshuar.

Më pas, namazfalësi thotë:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.”

Çdo lavdërim dhe falënderim i takon Allahut, sepse çdo madhështi buron prej Tij dhe çdo mëshirë vjen nga Ai. Ai është burimi i të gjitha virtyteve dhe prej Tij burojnë të gjitha të mirat dhe bamirësitë. Prandaj, falënderimi ndaj Tij është falënderim për çdo mirësi dhe vlerësim për çdo përpjekje që bëhet në rrugën e së mirës.

Çdokush që sheh te vetja një cilësi të lavdërueshme duhet ta konsiderojë atë si një dhuratë që buron nga mirësia, mëshira, kujdesi dhe bujaria e Allahut. Kjo sepse Allahu është Ai që ka mbjellë në natyrën e njeriut farat e mirësisë, e ka bërë shpirtin e tij të aftë të pranojë virtytin dhe bamirësinë dhe i ka dhënë vendosmërinë dhe vullnetin, të cilat janë mjete të tjera për të ecur në rrugën e mirësisë dhe të së drejtës.

Kjo mënyrë e të menduarit ia mbyll njeriut dyert e vetëpëlqimit dhe të mendjemadhësisë, si dhe e pengon atë t’i shpërdorojë ose t’i lërë të pashfrytëzuara cilësitë e mira dhe aftësitë që zotëron.

Në shprehjen “رَبِّ الْعَالَمِينَ” **(“Zoti i botëve”)** ndihet prania e kësaj bote dhe e botëve të tjera, si dhe lidhja

ndërmjet tyre. Namazfalësi e kupton se përtej kësaj bote, përtej pamjes së saj të kufizuar dhe rrethit të ngushtë që ai mund t'i ketë caktuar jetës së vet, ekzistojnë botë të tjera, hapësira të pafundme, galaktika dhe universe të panumërta, dhe se Zoti i tij është Zoti i të gjitha këtyre krijesave.

Kjo ndjenjë e çliron njeriun nga mendësia e ngushtë dhe afatshkurtër. Ajo i jep guxim, shpirt kërkimi dhe hulumtimi, si dhe krenari për të qenët rob i Allahut të Madhëruar. Madhështia dhe fisnikëria e adhurimit të Allahut i shfaqen atij në një mënyrë mahnitëse.

Nga ana tjetër, ai i sheh të gjitha krijesat, njerëzit, kafshët, bimët, sendet e pajeta, qiejt dhe botët e panumërta të ekzistencës si krijesa të Allahut, ndërsa Allahun si Rregulluesin dhe Udhëheqësin e tyre. Ai e kupton se Zoti i tij nuk është vetëm Zoti i racës së tij, i popullit të tij apo edhe i mbarë njerëzimit, por është gjithashtu Zoti i asaj milingoneje të vogël dhe i asaj bime të brishtë; Zoti i qiejve, i galaktikave dhe i yjeve.

Kur e kupton këtë të vërtetë, ai ndien se nuk është i vetmuar. Ai e kupton se është i lidhur me çdo grimcë të universit, me çdo krijesë të vogël e të madhe dhe me të gjithë njerëzit. Njerëzit janë vëllezërit dhe bashkudhëtarët e tij në këtë udhëtim, ndërsa i gjithë ky karvan i madh i krijimit po ecën drejt një qëllimi të vetëm.

Kjo lidhje dhe kjo afërsi e bëjnë atë ta shohë veten si përgjegjës ndaj të gjitha krijesave: përgjegjës për udhëzimin dhe ndihmën e njerëzve, për njohjen e krijesave të tjera dhe për përdorimin e tyre në mënyrën e drejtë, në përputhje me qëllimin për të cilin janë krijuar.

Pas falënderimit të Allahut, namazfalësi thotë:

الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ

"Gjithmëshirëshmit, Mëshirëplotit"

Mëshira e përgjithshme e Allahut shfaqet në formën e forcave krijuese, të ligjeve shpëtuese dhe të burimeve të energjisë që janë shpërndarë te të gjitha krijesat. Çdo qenie përfiton nga kjo mëshirë derisa t'i vijë afati i saj.

Ndërsa mëshira e Tij e veçantë, mëshira e udhëzimit, e ndihmës, e shpërblimit dhe e përkujdesjes së Tij, përfshin robërit e mirë dhe të devotshëm. Kjo mëshirë shtrihet si një vijë e qartë që nga kjo botë, përgjatë jetës së këtyre njerëzve të mirë e fisnikë, vazhdon pas vdekjes deri në Ditën e Kiametit, madje edhe deri te vendbanimi i fundit i ekzistencës së njeriut.

Prandaj, Allahu është burimi i një mëshire të përgjithshme dhe të përkohshme, si dhe burimi i një mëshire të veçantë dhe të përhershme.

Përmendja e cilësisë së mëshirës së Allahut në hyrje të Kur'anit, në fillim të namazit dhe në fillim të çdo sureje është dëshmi e dhembshurisë dhe e përkujdesjes së Tij. Kjo është cilësia më e dukshme në arenën e krijimit dhe të ekzistencës.

Ndryshe nga zemërimi dhe ndëshkimi i Tij, të cilat godasin veçanërisht kundërshtarët e së vërtetës, të korruptuarit dhe kriminelët, mëshira e Tij është gjithëpërfshirëse dhe shtrihet mbi të gjitha krijesat.[4]

مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ

"Sunduesi i Ditës së Gjykimit."

Dita e shpërblimit është dita e përfundimit, e fatit dhe e rezultatit përfundimtar. Të gjithë njerëzit përpiqen për të ardhmen e tyre. Si materialisti, ashtu edhe adhuruesi kanë një pikë të përbashkët: të dy kërkojnë rrugën drejt fatit dhe përfundimit të tyre. Por ndryshimi qëndron në mënyrën se si secili e kupton këtë fund.

Për materialistin, e ardhmja përbëhet nga një orë tjetër, një ditë tjetër, një vit ose disa vite të tjera, pastaj nga

[4] **"Mëshira Ime përfshin çdo gjë."** (Sure "El-A'raf", ajeti 156. Dhe në një lutje të transmetuar thuhet: "O Ti, mëshira e të Cilit ka paraprirë ndaj zemërimit të Tij."

pleqëria, dobësia dhe zhdukja. Ndërsa adhuruesi ka një horizont më të gjerë dhe një vizion më të largët. Në sytë e tij, kjo botë nuk është e mbyllur, e kufizuar dhe e përfunduar. Përkundrazi, bota është e gjerë dhe e ardhmja është e pakufishme.

Kjo sjell një shpresë që nuk shuhet dhe një përpjekje që nuk njeh lodhje. Ai që nuk e sheh vdekjen si fundin e shpresës, por e konsideron atë si pragun ku shfaqen rezultatet dhe shpërblimet e veprave të tij, është në gjendje të vazhdojë deri në çastin e fundit të jetës me të njëjtin entuziazëm dhe me të njëjtën gjallëri me të cilat e filloi rrugën e përpjekjes për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Kujtimi se Allahu është Sunduesi, Vendimmarrësi dhe Gjykatësi i Ditës së Kiametit e orienton namazfalësin në drejtimin e duhur dhe u jep veprave të tij ngjyrë hyjnore. Kështu, jeta e tij, në të gjitha aspektet, bëhet për Allahun dhe në rrugën e Tij. Ai i kushton të gjitha përpjekjet dhe gjithçka që zotëron përparimit dhe lartësimit të njerëzimit, sepse kjo është rruga e vetme që çon në kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Nga një këndvështrim tjetër, kjo bindje e çliron njeriun nga mbështetja në mendime të kota dhe shpresa të rreme, si dhe forcon tek ai shpresën e vërtetë, të bazuar në veprim.

Në sistemet e gabuara dhe të devijuara të kësaj bote, ndodh që njerëzit e dobët moralisht dhe oportunistët ta përmirësojnë gjendjen e tyre përmes mashtrimit, hipokrizisë dhe gënjeshtrës, madje të korrin frytet e mundit dhe të djersës së të tjerëve. Por në Botën Tjetër, ku Allahu, i Gjithëdijshmi dhe i Drejti, është Zotëruesi absolut i të gjitha çështjeve dhe ku mashtrimi, gënjeshtra dhe hipokrizia nuk kanë vend, askush nuk do të marrë asgjë pa punë dhe pa meritë.

Këtu përfundon pjesa e parë e sures "El-Fatiha", e cila përmban lavdërimin e Krijuesit të botëve dhe përmendjen e cilësive më të rëndësishme të Tij.

Ndërsa pjesa e dytë e kësaj sureje, e cila përmban shprehjen e robërisë ndaj Allahut dhe kërkimin e udhëzimit prej Tij, tregon qartë një pjesë të parimeve më themelore të ideologjisë islame.

Kjo pjesë e sures "El-Fatiha" fillon me frazën:

إِيَّاكَ نَعْبُدُ

"Vetëm Ty të adhurojmë."

Kjo do të thotë se e gjithë ekzistenca jonë dhe të gjitha aftësitë tona fizike, shpirtërore dhe mendore janë në dorën e Allahut, i përkasin Atij dhe janë të nënshtruara ndaj Tij.

Kur namazfalësi e shqipton këtë fjali, ai i këput prangat e robërisë ndaj çdo gjëje tjetër përveç Allahut nga duart, këmbët dhe qafa e tij. Ai i përgjigjet thirrjes së Allahut dhe i refuzon pretenduesit e hyjnisë, të cilët gjatë historisë kanë qenë shkaku që masa të mëdha njerëzish të mbeten të lidhur me zinxhirët e robërisë, shtypjes dhe nënshtrimit. Ai e afron veten dhe të gjithë besimtarët më shumë drejt bindjes ndaj Allahut dhe zbatimit të urdhrave të Tij. Me pak fjalë, duke pranuar robërinë ndaj Allahut, ai çlirohet nga çdo robëri tjetër dhe kështu hyn në radhën e monoteistëve të vërtetë.

Pranimi se adhurimi i takon vetëm Allahut është një nga parimet më të rëndësishme mendore dhe praktike të Islamit dhe të të gjitha feve qiellore. Ky parim shprehet me fjalët "ekskluziviteti i hyjnisë për Allahun", që do të thotë se vetëm Allahu duhet të adhurohet dhe se askush tjetër përveç Tij nuk meriton adhurim.

Gjithmonë ka pasur njerëz që nuk e kanë kuptuar siç duhet këtë të vërtetë. Ata kanë nxjerrë prej saj përfundime të gabuara dhe të kufizuara dhe kështu, pa e kuptuar, kanë rënë në robërinë e dikujt tjetër përveç Allahut. Ata kanë menduar se adhurimi i Allahut kufizohet vetëm në madhërimin dhe lutjen ndaj Tij. Duke qenë se falnin namaz dhe i luteshin vetëm Allahut, ishin të bindur se nuk adhuronin askënd tjetër.

Megjithatë, kuptimi i gjerë i "ibadetit" (adhurimit) në terminologjinë e Kur'anit dhe të hadithit është më i thellë. Sipas Kur'anit dhe hadithit, adhurimi do të thotë bindje, dorëzim dhe nënshtrim i plotë ndaj urdhrit, ligjit dhe sistemit që i imponohet njeriut nga çdo autoritet apo fuqi, pavarësisht nëse ky nënshtrim shoqërohet me madhërim e lutje apo jo.

Prandaj, të gjithë ata që u nënshtrohen sistemeve, ligjeve dhe urdhrave që burojnë nga një autoritet tjetër përveç Allahut janë, në njëfarë mënyre, adhurues të atyre sistemeve dhe të atyre që i kanë krijuar ato, edhe nëse zbatojnë disa pjesë të ligjit të Allahut dhe lënë pas dore pjesë të tjera.

Ndërsa ai që nuk vepron fare sipas ligjit të Allahut bëhet mohues i së vërtetës së qartë dhe të ndritshme të ekzistencës së Allahut, duke e mohuar atë me bindje ose me vepra.

Duke e kuptuar këtë këndvështrim islam, bëhet e lehtë të kuptohet se çfarë synonin fetë qiellore, të cilat e fillonin thirrjen e tyre me fjalën: "*Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut*." Çfarë mesazhi përcillnin? Çfarë kërkonin? Dhe kundër kujt ngriheshin?

Kjo e vërtetë, pra kuptimi i vërtetë i adhurimit, shprehet aq qartë dhe përsëritet aq shpesh në burimet islame, në Kur'an dhe në hadithe, saqë nuk lë vend për

dyshim te studiuesit dhe mendimtarët. Për ta ilustruar këtë, mjafton të përmendim një ajet kur'anor dhe një hadith nga Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)*.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهْبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِن دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ﴾

"Ata i morën dijetarët dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut, si edhe Mesihun, birin e Merjemes; ndërkohë që nuk ishin urdhëruar veçse të adhuronin një Zot të vetëm. Nuk ka Zot tjetër përveç Tij."[5]

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* u pyet për kuptimin e fjalës së Allahut:

﴿وَالَّذِينَ اجْتَنَبُوا الطَّاغُوتَ أَنْ يَعْبُدُوهَا وَأَنَابُوا إِلَى اللَّهِ لَهُمُ الْبُشْرَى﴾

"Ndërsa ata që iu shmangën tagutit që të mos e adhuronin atë dhe iu kthyen Allahut, për ta ka përgëzim."[6]

Imami *(paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Ju jeni ata. Dhe kush i bindet një tirani, ai e ka adhuruar atë."* [7]

[5] Sure "Et-Teube", ajeti 31.
[6] Sure "Ez-Zumer", ajeti 18
[7] Sure "En-Nisa", ajeti 69.

Në vazhdim namazfalësi thotë:

وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“Dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë.”

Ne nuk presim asnjë ndihmë apo përkrahje nga rivalët e Allahut dhe nga ata që pretendojnë hyjni për veten, sepse e njëjta arsye që i ka shtyrë këta njerëz të mohojnë hyjninë e Allahut i pengon edhe të ndihmojnë robërit e Tij që ecin në rrugën e Tij.

Rruga e Allahut është rruga e profetëve të Tij; rruga e së vërtetës, e drejtësisë, e vëllazërisë, e solidaritetit dhe e bashkëjetesës mes të gjithë njerëzve. Ajo është rruga që i jep njeriut vlerën e tij dhe refuzon fanatizmin, padrejtësinë dhe diskriminimin.

Ndërsa kundërshtarët e Allahut dhe ata që pretendojnë pushtet mbi njerëzit i kanë përqendruar të gjitha planet e tyre te interesat e tyre të ulëta dhe te pasuritë që kanë grabitur, me synimin për të shkatërruar vlerat dhe aftësitë e vërteta njerëzore. Atëherë, si mund t’u japin ata ndihmë dhe përkrahje robërve të Allahut? Ata janë në një luftë të vazhdueshme dhe të pamëshirshme kundër robërve të Allahut.

Prandaj, ndihmën e kërkojmë vetëm nga Allahu: nga fuqia e mendjes dhe e vullnetit që Ai ka vendosur brenda nesh; nga shkaqet dhe mjetet që na ka vënë në dispozicion;

nga ligjet dhe rregullat natyrore e historike, të cilat, nëse njihen, mund të hapin rrugën për dijen dhe veprimin; si dhe nga të gjitha dhuntitë dhe aftësitë që janë pjesë e ushtrive të Tij të fuqishme, të vendosura në shërbim të njerëzimit.

Në vazhdim, namazfalësi thotë:

اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

"Na udhëzo në rrugën e drejtë."

Nëse njeriu do të kishte nevojë për diçka më të rëndësishme dhe më parësore sesa udhëzimi, padyshim që ajo do të përmendej në suren "El-Fatiha", e cila është hyrja e Kur'anit dhe pjesa më e rëndësishme e namazit, në formën e një lutjeje dhe kërkese drejtuar Allahut.

Përmes udhëzimit hyjnor, mendja dhe përvoja vendosen në rrugën e drejtë, të dobishme dhe shpëtuese. Pa këtë udhëzim, mendja dhe përvoja bëhen si një llambë në dorën e një kusari ose si një thikë në dorën e një të çmenduri.

"Na udhëzo në rrugën e drejtë" do të thotë: Na udhëzo drejt atij plani të natyrshëm (fitrij), drejt atij programi që është ndërtuar mbi bazën e kuptimit të saktë të nevojave natyrore të njeriut, të mundësive dhe të aftësive të tij.

Kjo është rruga që profetët e Allahut ua kanë hapur njerëzve. Ata ishin kërkuesit dhe pararendësit e parë në rrugën drejt së vërtetës.

Është rruga në të cilën, nëse njerëzit hyjnë dhe ecin, do t'i ngjajnë ujit që rrjedh natyrshëm në shtratin e tij dhe lëviz vetvetiu, pa pasur nevojë për ndonjë forcë tjetër, drejt qëllimit të tij përfundimtar: detit të madh të përsosmërisë njerëzore.

Është një program që, nëse do të merrte formën e një sistemi shoqëror dhe do të zbatohej në jetën e njerëzve, do t'u sillte atyre mirëqenie të vërtetë, stabilitet, liri, bashkëpunim, solidaritet dhe vëllazëri. Ai do t'u jepte fund shumë prej vuajtjeve dhe tragjedive të vazhdueshme të njerëzimit.

Por cila është kjo rrugë dhe cili është ky program? Në këtë treg të mbushur me pretendime, të gjithë pretendojnë se kanë të drejtë dhe çdo grup e konsideron tjetrin të gabuar. Prandaj, është e nevojshme të përcaktohen shenjat dalluese dhe kuptimi i saktë i kësaj shprehjeje të shkurtër, "rruga e drejtë", sipas këndvështrimit të Kur'anit. Për këtë arsye, surja vazhdon:

﴿صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ﴾

"Në rrugën e atyre të cilëve u ke dhuruar mirësi."

Cilët janë ata që Allahu i ka përfshirë me mirësinë e Tij dhe u ka dhuruar këtë mirësi? Pa dyshim, këtu nuk bëhet fjalë për pasuri, pozitë apo kënaqësi materiale, sepse shembujt më të dukshëm të atyre që i kanë pasur këto të mira shpesh kanë qenë armiqtë më të mëdhenj të Allahut dhe të krijesave të Tij.

Përkundrazi, me këtë mirësi nënkuptohet një dhunti më e madhe se zbukurimet e kësaj bote. Është mirësia e kujdesit, e mëshirës dhe e udhëzimit të Allahut. Është mirësia e njohjes së vlerave të vërteta të shpirtit dhe e rikthimit të njeriut te vetvetja e tij e vërtetë.

Në një vend tjetër, Kur'ani Famëlartë i përshkruan ata që e kanë fituar këtë mirësi:

﴿وَمَن يُطِعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ...﴾

"**Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhuruar mirësi: me profetët, të vërtetët, dëshmorët dhe të mirët…"**[8]

Prandaj, falësi i namazit, përmes kësaj fjalie, i kërkon Allahut që ta udhëzojë në rrugën e profetëve, të të vërtetëve, të dëshmorëve dhe të njerëzve të devotshëm.

[8] Tefsiri "Nur Eth-Thekalejn", vëllimi 5, faqja 481.

Kjo është një vijë e qartë që shtrihet përgjatë gjithë historisë. Është një rrugë e hapur, me një qëllim të përcaktuar dhe me udhëtarë të njohur.

Përballë saj ekziston një rrugë tjetër, e cila është gjithashtu e qartë dhe ka ndjekësit e saj të njohur. Duke përmendur këtë rrugë dhe ndjekësit e saj, falësi i namazit paralajmëron dhe këshillon veten që të mos shkelë në të dhe të mos devijojë drejt saj.

Këtë e sqaron pjesa tjetër e kësaj lutjeje, e cila vijon kështu:

غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ

"Jo në rrugën e atyre që kanë merituar zemërimin Tënd."

Kush janë ata mbi të cilët ka rënë zemërimi i Allahut? Ata janë njerëzit që kanë hedhur hapa në një rrugë tjetër, në kundërshtim me rrugën e Allahut, dhe kanë tërhequr pas vetes shumë njerëz të tjerë: disa të pavëmendshëm, të dobët e pa vullnet, ndërsa të tjerë, megjithëse e kuptonin të vërtetën, i kanë detyruar me forcë të ecin në atë rrugë.

Ata janë njerëzit që, gjatë historisë, kanë marrë në duart e tyre drejtimin e çështjeve të njerëzve përmes dhunës, arrogancës, mashtrimit dhe hipokrizisë. Ata i kanë shndërruar njerëzit në qenie të nënshtruara dhe në mjete të varura prej tyre, duke i shtypur dhe dobësuar. Ata kanë krijuar kushtet për përhapjen e imoralitetit dhe të

marrëdhënieve të shthurura, duke i mashtruar njerëzit dhe duke ushtruar sundim mbi ta.

Me fjalë të tjera, njerëzit që kanë merituar zemërimin e Allahut janë ata që kanë ndjekur rrugën e devijimit, jo për shkak të paditurisë apo pavëmendjes, por si pasojë e kokëfortësisë, egoizmit dhe dashurisë së tepruar për veten.

Në rrjedhën e historisë, ky grup përbëhej kryesisht nga shtresat e pasura dhe të fuqishme, të cilat vazhdimisht janë përballur me kundërshtimin e grupeve fetare. Kjo sepse synimet e fesë binin ndesh drejtpërdrejt me parimet mbi të cilat mbështetej ekzistenca e këtyre shtresave. Për këtë arsye, hapi i parë që ndërmerrnin grupet fetare ishte kundërshtimi i tyre.

Përveç këtyre dy grupeve, grupit të të udhëzuarve dhe grupit të atyre që kanë merituar zemërimin e Allahut, ekziston edhe një grup i tretë, rruga e të cilit përfundon në të njëjtin destinacion me atë të atyre që kanë merituar zemërimin e Allahut.[9]

Fjalia e mëposhtme i referohet këtij grupi njerëzish:

وَلَا الضَّالِّينَ

[9] Kjo çështje është sqaruar në disa ajete të Kur'anit, me shprehje të pasura me kuptime dhe në raste të ndryshme, ndër to: Sure "Esh-Shuara", ajetet 91–102; Sure "Sad", ajetet 58–61; Surja "Ibrahim", ajetet 21–22; Sure "Gafir", ajetet 47–48.

“Dhe jo në rrugën e të humburve.”

Ata janë njerëzit që, nga padituria dhe pavëmendja, duke ndjekur udhëheqësit e tyre devijues, kanë marrë një rrugë tjetër, të ndryshme nga rruga e Allahut dhe e së vërtetës, ndërkohë që mendojnë se po ecin në rrugën e drejtë. Por, në të vërtetë, ata ecin në një rrugë të rrezikshme dhe shkojnë drejt një përfundimi të hidhur.

Edhe ky grup dallohet qartë përgjatë historisë. Në të bëjnë pjesë të gjithë ata që, në sistemet e injorancës (xhahilijetit), u bindeshin verbërisht urdhrave të zotërinjve dhe udhëheqësve të tyre. Për hir të tyre, ata i konsideronin të gabuar ata që thërrisnin për të vërtetën, drejtësinë dhe fenë e Allahut. Madje, ndonjëherë ngriheshin edhe kundër tyre.

Ata nuk i lejonin vetes as edhe për një çast ta rishikonin rrugën që kishin marrë, ndonëse e kishin zgjedhur atë për shkak të paditurisë dhe pavëmendjes. Ne e quajmë këtë padituri, sepse ajo u shërben interesave të shtresave arrogante dhe shtypëse, ndërsa vetë këta njerëz të humbur shkatërrojnë veten.

Përkundrazi, thirrja e profetëve i çrrënjos themelet e grupit mbi të cilin ka rënë zemërimi i Allahut dhe vepron në dobi të shtresave të privuara dhe të shtypura, përfshirë edhe këta njerëz të mashtruar.

Kur namazfalësi kujton këto dy gjendje: gjendjen e "atyre që kanë merituar zemërimin e Allahut" dhe gjendjen e "të humburve", tek ai krijohet një ndjeshmëri dhe kujdes më i madh për të përcaktuar rrugën në të cilën duhet të ecë dhe qëndrimin që duhet të mbajë ndaj namazit shpëtues, në të cilin thërrasin profetët.

Atëherë, nëse ai vëren në sjelljen dhe mënyrën e tij të jetesës shenja të pjekurisë dhe të gjetjes së rrugës së drejtë, e përsërit edhe një herë, me falënderim për këtë mirësi të madhe, duke thënë:

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾

"Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve." [10]

Dhe me këtë përfundon një pjesë e rëndësishme e namazit.

Kjo ishte hyrja e Kur'anit, e njohur si **"Fatihatul-Kitab"** (Hyrja e Librit). Ashtu si hyrja e çdo libri, edhe hyrja e Kur'anit jep një pasqyrë të përgjithshme të njohurive që përmban ai. Ashtu si namazi është një përmbledhje dhe një pasqyrë e shkurtër e Islamit, në të cilën përfshihen shumë aspekte dhe parime të rëndësishme të ideologjisë islame, edhe surja "El-Fatiha" paraqet në mënyrë të përmbledhur

[10] Është thënë se është e pëlqyeshme (mustehab) shqiptimi i kësaj fjalie pas përfundimit të Sures "El-Fatiha".

pikat kryesore dhe linjat e përgjithshme të njohurive të Kur'anit, duke përfshirë udhëzimet e tij më të rëndësishme.

Prandaj, të gjitha botët dhe i gjithë universi përbëjnë një tërësi të vetme, të ndërlidhur, të krijuar nga i njëjti Zot, i Cili është **"Zoti i botëve"**:

﴿رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾

Çdo gjë dhe çdo njeri është nën mëshirën dhe përkujdesjen e Allahut. Ndërsa besimtarët gëzojnë mëshirën dhe përkujdesjen e Tij të veçantë:

﴿الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ﴾

"I Gjithmëshirëshmi, Mëshirëploti."

Jeta e njeriut vazhdon edhe pas kësaj bote, ndërsa sundimi absolut në botën tjetër i takon Allahut:

﴿مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ﴾

"Sunduesi i Ditës së Gjykimit."

Njeriu duhet të çlirohet nga robëria ndaj gjithçkaje tjetër përveç Allahut dhe të jetojë nën përkujdesjen e Tij, duke ruajtur cilësitë e tij njerëzore dhe duke ecur në rrugën e përsosmërisë njerëzore, i lirë dhe me vullnetin e tij të lirë:

﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë.”

Ai duhet t’i kërkojë Allahut rrugën e lumturisë dhe rrugën e drejtë në jetën e tij:

﴿اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ﴾

“Na udhëzo në rrugën e drejtë.”

Ai duhet të dallojë drejtimet që ndjekin armiqtë dhe miqtë, të njohë mendimet dhe strategjitë e tyre, si dhe të përcaktojë qëndrimin e tij ndaj të dyja palëve, në përputhje me kërkesat e besimit të tij:

﴿صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ...﴾

“Në rrugën e atyre të cilëve u ke dhuruar mirësi…”.

Pas përfundimit të kësaj bisede edukative me Allahun, të mbushur me kuptime të thella, namazfalësi duhet të lexojë një sure të plotë nga Kur’ani. Ky lexim është një pjesë nga Kur’ani, të cilën falësi e zgjedh me vullnetin dhe dëshirën e tij, dhe përmes saj hapet para tij një kapitull tjetër nga njohuritë e shenjta islame.

Detyrimi për të lexuar Kur’an gjatë namazit, siç ka shpjeguar Imam Ali ibn Musa er-Rida *(paqja qoftë mbi të!)* në hadithin e transmetuar nga Fadl ibn Shadhani, është vendosur për këtë arsye: “*Njerëzit janë urdhëruar të lexojnë*

Kur'an në namaz, në mënyrë që Kur'ani të mos mbetet i braktisur dhe i lënë pas dore, por të studiohet, që të mos zhduket dhe të mos mbetet i panjohur."

Këtu do të mjaftohemi me një përmendje të shkurtër të sures së Teuhidit ("El-Ikhlas"), e cila zakonisht lexohet gjatë namazit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

"Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirëshmit, Mëshirëplotit."

قُلْ

"Thuaj!"

O i Dërguar, beso në këtë të vërtetë dhe përcillua atë edhe të tjerëve.

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ

"Thuaj: Ai është Allahu, Një i Vetëm."

Ai nuk ka as ortak, as të ngjashëm, as rival, siç pretendojnë disa besime fetare të shtrembëruara.

Bota e krijimit nuk është një arenë ku zotat përplasen dhe luftojnë mes tyre. Përkundrazi, të gjitha ligjet dhe rregullat që qeverisin botën burojnë nga një vullnet i vetëm

dhe nga një fuqi e vetme. Për këtë arsye, në botën e krijimit mbizotërojnë rendi dhe harmonia.

Të gjitha ligjet, ndryshimet dhe lëvizjet natyrore në univers janë të drejtuara drejt një qëllimi të vetëm dhe ndjekin një sistem të përbashkët.

Vetëm njeriu, të cilin Allahu e ka pajisur me vullnet, liri zgjedhjeje dhe aftësi për të marrë vendime, mund të rebelohet kundër këtij rendi dhe të lëshojë një tingull të papërshtatshëm, që bie ndesh me melodinë e përgjithshme të krijimit.

Por ai mund të zgjedhë gjithashtu një jetë në përputhje me ligjet e ekzistencës dhe të ecë në harmoni me rendin e vendosur nga Allahu.

اللَّهُ الصَّمَدُ

"**Allahu është i Pavaruri Absolut** (Ai tek i Cili drejtohen të gjitha krijesat për nevojat e tyre)."

Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd. Prandaj, unë përulem para Tij, e madhëroj dhe e falënderoj Atë, ndryshe nga zotat e tjerë, të cilët kanë nevojë për dikë tjetër për ekzistencën e tyre, për vazhdimësinë e jetës, për fuqinë dhe për aftësinë për t'u përkujdesur për të tjerët.

Një Zot i tillë nuk meriton të nderohet dhe të madhërohet nga njeriu, sepse do të ishte një qenie e

ngjashme me të, madje edhe më e ulët se ai. Njeriu, kjo qenie madhështore, me një natyrë të thellë e të ndërlikuar, nuk duhet të madhërojë askënd tjetër përveç një Fuqie që nuk ka as nevojën më të vogël për ndonjë qenie apo faktor tjetër, sepse ekzistenca, fuqia dhe përjetësia e Tij burojnë nga vetë Qenia e Tij.

لَمْ يَلِدْ

"Ai nuk ka lindur."

Ai nuk është ashtu siç e kanë përshkruar fetë e shtrembëruara, besimet e kota dhe doktrinat politeiste. Ai nuk është ai "Zot i të krishterëve dhe i politeistëve", të cilit ata i kanë atribuar një bir apo disa bij.

Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe i çdo njeriu. Ai nuk është babai i tyre, por të gjithë banorët e qiejve dhe të tokës janë robërit e Tij, jo fëmijët e Tij.

Marrëdhënia e zotërimit të Allahut dhe e robërisë së njeriut ndaj Tij është ajo që i pengon robërit e vërtetë të Allahut të adhurojnë çfarëdo gjëje apo këdo tjetër përveç Tij, sepse adhurimi i dy zotave njëkohësisht është i pamundur.

Ata që e kanë paraqitur Allahun si një baba të dashur për krijesat dhe njerëzit si fëmijët e Tij nuk e kanë kuptuar realitetin e robërisë së njeriut ndaj Allahut dhe faktin se kjo robëri përbën një pozitë nderi dhe lartësimi për njeriun.

Në të vërtetë, ata kanë hapur rrugën për adhurimin e dikujt tjetër përveç Allahut. Në praktikë, ata janë bërë robër të shumë "zotërve" të kësaj bote, duke humbur fisnikërinë e tyre njerëzore dhe duke u shndërruar në mjete në duart e tregtarëve të skllevërve dhe të shfrytëzuesve.

Më pas, surja vazhdon:

وَلَمْ يُولَدْ

"Dhe Ai nuk është i lindur."

Ai nuk është një qenie që dikur nuk ekzistonte dhe më pas erdhi në ekzistencë. Ai nuk është krijuar apo lindur nga dikush dhe nuk është as fryt i ndonjë ideje apo besimi. Ai nuk është produkt i ndonjë sistemi, shtrese shoqërore apo forme të jetës njerëzore. Ai është realiteti më fisnik dhe më i lartë. Ai është një e vërtetë e përjetshme: ka ekzistuar gjithmonë dhe do të ekzistojë përgjithmonë.

وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ

"Dhe askush nuk është i barabartë me Të."

Ai nuk ka të ngjashëm dhe asgjë nuk mund të krahasohet me Të. Fusha e ndikimit dhe e sundimit të Tij, që përfshin të gjithë universin, nuk mund të ndahet ndërmjet Tij dhe askujt tjetër.

Nuk mund të ndodhë që një pjesë e jetës së njeriut t'i përkasë Allahut, ndërsa pjesa tjetër t'u përkasë zotave të tjerë, qofshin ata të gjallë apo të pajetë, ose atyre që pretendojnë se zotërojnë fuqi dhe hyjni.

Kjo sure është një mënyrë për t'i njohur myslimanët dhe mbarë njerëzimin me Zotin, i Cili, sipas këndvështrimit islam, është i denjë për adhurim dhe madhërim. Një Zot që nuk është i vetëm dhe që ka qindra e mijëra të ngjashëm e rivalë në botë nuk është i denjë për t'u njohur si Zot dhe për t'u adhuruar. Një fuqi që ka nevojë për një qenie tjetër për të vazhduar ekzistencën e saj nuk mund dhe nuk duhet t'i imponohet njerëzimit si objekt adhurimi.

Ai që madhëron zotat e dobët, të varur, të krijuar dhe të përkohshëm, si dhe përkulet para tyre, shkatërron dinjitetin e tij njerëzor, duke ulur jo vetëm veten, por edhe njerëzimin.

Kjo është ana pozitive e sures së Teuhidit, e cila paraqet cilësitë e të Adhuruarit dhe të Zotit të njeriut, si dhe vërteton pavlefshmërinë e zotave të rremë përgjatë gjithë historisë.

Nga ana tjetër, kjo sure i paralajmëron robërit e Allahut dhe myslimanët që të mos përfshihen në përsiatje filozofike që ngjallin dyshime dhe vesvese lidhur me Qenien e Allahut dhe cilësitë e Tij.

Ajo i mëson ata ta përmendin Allahun dhe t'i luten Atij me fjalë të thjeshta, përmes të cilave pretenduesit dhe mohuesit përjashtohen nga pozita e shenjtë e zotësisë hyjnore.

Në vend që të zhytet në përsiatje filozofike dhe hamendësime mendore, njeriu duhet të mendojë për përgjegjësitë që burojnë nga besimi në Teuhid. Siç transmetohet në një hadith nga Imam Ali ibn Husejni, i njohur si Imam Zejnul Abidin *(paqja qoftë mbi të!)*: *"Allahu i Madhëruar e dinte se në fund të kohëve do të vinin njerëz që do të thelloheshin shumë (në çështjet që lidhen me natyrën e Allahut). Prandaj, Allahu i Lartësuar shpalli:*

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ﴾

'Thuaj: Ai është Allahu, Një i Vetëm' dhe ajetet nga Surja El-Hadid deri te fjala e Tij:

﴿عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ﴾

"Ai është i Gjithëdijshëm për atë që gjendet në zemra."

Prandaj, kush kërkon përtej kësaj, do të shkatërrohet." [11]

Duket sikur kjo sure i thotë namazfalësit: Allahu është një fuqi e veçantë dhe e lartë. Ai është i pavarur në Qenien e Tij dhe nuk ka nevojë për askënd:

[11] "Nur Eth-Thekalejn", vëllimi 5, transmetuar nga "Usulul-Kafij".

﴿لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ﴾

“Ai nuk ka lindur askënd dhe nuk është i lindur.”

Ai nuk ka as të ngjashëm, as të barabartë me Të… dhe kjo mjafton.

Ndërsa dija, njohja, urtësia dhe cilësitë e tjera të Allahut, të cilat myslimani duhet t’i njohë dhe që ndikojnë në jetën dhe ngritjen e tij shpirtërore, përmenden edhe në ajete të tjera të Kur’anit.

Por mos u zhyt më thellë se kaq në natyrën e Qenies së Allahut dhe në mënyrën se si shfaqen cilësitë e Tij. Ti do të arrish një njohje më të thellë përmes veprimit.

Mos mendo se do të arrish një njohje më të thellë vetëm përmes kërkimeve dhe analizave të thella mendore. Përpiqu ta fitosh këtë njohje përmes pastërtisë së shpirtit, përmes përkushtimit të brendshëm shpirtëror dhe duke zbatuar kërkesat e Teuhidit në jetën tënde.

Kështu ishin profetët dhe të sinqertët: ata ishin robërit e vërtetë të Allahut, monoteistë të sinqertë dhe njohës të Tij.

Para se të hyjmë në shpjegimin e përmendjeve (dhikreve) që namazfalësi thotë në ruku dhe sexhde, po sqarojmë fjalitë që namazfalësi i përsërit duke qëndruar në këmbë në rekatin e tretë dhe të katërt.

Këto fjali përbëjnë katër përmendje, të cilat shprehin katër të vërteta rreth Allahut të Madhëruar:

سُبْحَانَ اللهِ

"I Pastër dhe i Lartësuar është Allahu nga çdo mangësi."

وَالْحَمْدُ لِلَّهِ

"Falënderimi i takon Allahut."

وَلَا إِلٰهَ إِلَّا اللهُ

"Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut."

وَاللهُ أَكْبَرُ

"Allahu është më i Madhi."

Njohja e këtyre katër veçorive ka një ndikim të thellë në formimin e një kuptimi të saktë dhe të plotë të Teuhidit (Njëshmërisë së Allahut), sepse secila prej këtyre përmendjeve është një shprehje e besimit në Teuhid.

Përsëritja e këtyre fjalive nuk bëhet vetëm për të shtuar njohuritë teorike të njeriut. Përkundrazi, përfitimi më i madh nga njohja e cilësive dhe veçorive të Allahut, si dhe nga përmendja e tyre e vazhdueshme, qëndron në faktin se ato e nxisin njeriun të veprojë, i zgjojnë ndjenjën e

përgjegjësisë dhe e bëjnë të ndihet i detyruar të veprojë në përputhje me të vërtetën që ka kuptuar.

Në përgjithësi, besimet islame duhet të dalin nga sfera e mendimit dhe të shfaqen në jetën e përditshme si burim veprimi dhe lëvizjeje. Rëndësia dhe vlera e këtyre besimeve nuk qëndrojnë vetëm në dimensionin e tyre teorik dhe abstrakt, por burojnë, në një masë të madhe, nga lidhja e tyre me jetën e njeriut, si dhe me sjelljen e individit dhe të shoqërisë.

Është e vërtetë se çdo besim islam përfshin njohjen e një të vërtete të caktuar, por njeriu duhet ta përvetësojë atë si besim vetëm atëherë kur ai sjell me vete një zotim dhe vendos mbi supet e tij një përgjegjësi të re.

Besimi në ekzistencën e Allahut është pikërisht i tillë. Si besimi në ekzistencën e Allahut, ashtu edhe mohimi i Tij, përcaktojnë një mënyrë të veçantë jetese dhe veprimi. Individi dhe shoqëria që besojnë vërtet në ekzistencën e Allahut ndjekin një mënyrë të caktuar jetese, ndërsa individi dhe shoqëria që e mohojnë këtë të vërtetë ndjekin një mënyrë tjetër.

Nëse njeriu beson se ai vetë dhe bota janë krijuar nga fuqia e Allahut, përmes një vullneti të vetëdijshëm dhe të urtë, ky besim e çon atë drejt një bindjeje tjetër: se krijimi ka një qëllim dhe një synim.

Ai bindet se ka një rol dhe një përgjegjësi për të arritur këtë qëllim. Pikërisht kjo ndjenjë përgjegjësie e shtyn atë drejt veprës, përpjekjes dhe bartjes së barrës së përgjegjësisë. Dhe përballë gjithë kësaj ai ndien kënaqësi dhe e pranon me zemër të hapur.

Po kështu, besimi në Ringjalljen, Profetësinë, Imamatin dhe në parime të tjera vendos përgjegjësi dhe detyrime mbi supet e besimtarit, duke përcaktuar mënyrën se si ai duhet të veprojë dhe të jetojë.

Nëse në jetën e përditshme shohim njerëz që e konsiderojnë veten besimtarë në këto parime themelore, por që, në sjelljen dhe mënyrën e tyre të jetesës, nuk dallojnë nga ata që nuk kanë as njohurinë më të vogël për këto parime dhe nuk besojnë në to, kjo ndodh për shkak të mungesës së njohjes së plotë ose sepse besimi dhe dorëzimi i tyre ndaj Allahut nuk janë rrënjosur thellë.

Në momentet vendimtare dhe në kthesat e jetës, dallohen njerëzit me besim të vërtetë nga imituesit e paditur dhe nga ata që ndjekin vetëm interesat e tyre. Duke pasur parasysh këtë këndvështrim, tani kthehemi te kuptimi dhe përmbajtja e këtyre katër përmendjeve.

E para:

سبحان الله

"I Pastër dhe i Lartësuar është Allahu nga çdo mangësi."

Allahu është i pastër dhe i lartësuar nga çdo ortakëri. Ai është i pastër nga padrejtësia, nga të qenët i krijuar, nga çdo veprim që bie ndesh me urtësinë dhe të mirën, si dhe nga të gjitha mangësitë, nevojat dhe të metat që ekzistojnë te krijesat. Ai është i pastër nga çdo cilësi që do të nënkuptonte se është një qenie e krijuar ose e varur nga diçka tjetër.

Kur namazfalësi e shqipton këtë fjali dhe përmend këtë veçori të Allahut, ai kupton dhe kujton se përballë kujt të Madhërishëm gjendet dhe përpara cilës Qenieje që meriton madhërim është përulur dhe ka shfaqur nderim. Ai ndien se madhërimi dhe përulja e tij janë përballë mirësisë dhe përsosmërisë absolute. A ndihet dikush i poshtëruar kur respekton pastërtinë, mirësinë dhe bukurinë absolute?!

Namazi islam është shprehje e përuljes dhe e madhërimit përpara këtij oqeani të pafund mirësie, përsosmërie dhe bukurie. Ai nuk është një përulje që e poshtëron njeriun apo që ia cenon vlerën, dinjitetin dhe nderin njerëzor. Po kështu, ai nuk është një lavdërim që e ul njeriun, e poshtëron apo e bën të ndihet i pavlerë.

A nuk është njeriu një qenie që e kupton bukurinë dhe e kërkon atë? Atëherë, është krejtësisht e natyrshme që ai të përkulet përpara përsosmërisë absolute, të adhurojë Qenien që e zotëron këtë përsosmëri dhe ta madhërojë Atë me gjithë qenien e tij. Ky madhërim dhe kjo robëri ndaj Allahut e tërheqin njeriun drejt rrugës së përsosmërisë,

mirësisë dhe bukurisë, duke e orientuar tërë jetën e tij në këtë drejtim.

Ata që e shohin adhurimin islam si diçka që e poshtëron njeriun dhe e krahasojnë atë me madhërimin e fuqive materiale, kanë anashkaluar një të vërtetë të hollë, por të rëndësishme: lavdërimi i mirësisë dhe i pastërtisë është, në vetvete, një nga nxitësit më të fuqishëm drejt mirësisë dhe pastërtisë.

Pikërisht këtë të vërtetë kujtojmë kur shqiptojmë:

سُبْحَانَ اللهِ

"I Pastër dhe i Lartësuar është Allahu nga çdo mangësi."

E dyta:

الْحَمْدُ لِلَّه

"Falënderimi i takon Allahut."

Gjatë gjithë jetës së tij të mundimshme, njeriu, për të siguruar përfitime të ndryshme, privilegje të vogla e të mëdha, për të zgjatur jetën qoftë edhe për disa ditë dhe, shpeshherë, vetëm për të siguruar bukën e gojës, e ka mbushur gojën me lavdërime dhe falënderime ndaj atyre që

janë të barabartë me të si krijesa dhe që nuk kanë asgjë që t'i bëjë më të lartë se ai.

Ai ka sakrifikuar veten dhe pasurinë e tij për zotërinjtë e vet, sepse i ka konsideruar ata burim të mirësive. Kështu, ai u është bindur dhe u është nënshtruar zotërinjve të tij, duke pranuar një robëri në të cilën jo vetëm trupi, por edhe shpirti dhe mendja u nënshtrohen atyre.

Kur njeriu kujton se të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, ai kupton se të gjitha mirësitë burojnë prej Tij. Prandaj, në të vërtetë, askush nuk zotëron asgjë që t'i japë të drejtën ta përdorë atë që zotëron për të skllavëruar një njeri tjetër, për ta nënshtruar dhe për ta kthyer në robin e tij.

Kjo bindje u mëson shpirtrave të dobët, zemrave të mahnitura dhe syve të mashtruar nga mirësitë që të mos i konsiderojnë dhuratat dhe mëshirën e zotërinjve dhe sunduesve të vegjël si diçka që buron prej vetë atyre.

Ajo i mëson ata të mos ua atribuojnë këto mirësi zotërinjve dhe sunduesve, të mos ua dorëzojnë atyre drejtimin e jetës së tyre dhe të mos pranojnë të privohen nga të mirat për hir të tyre. Përkundrazi, ata duhet të kuptojnë se kushdo që pretendon pronësinë mbi këto mirësi, i mban ato për vete dhe i përdor si mjet shtypjeje, është thjesht një uzurpues, një rrëmbyes dhe një shkelës i të drejtave.

E treta:

لَا إِلٰهَ إِلَّا اللهُ

"Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut."

Kjo është parulla e Islamit, e cila shpreh botëkuptimin dhe pikëpamjen ideologjike të kësaj feje. Ajo përmban dy elemente themelore: mohimin dhe pohimin. Fillimisht, mohon të gjitha fuqitë tiranike dhe johyjnore. Njeriu çlirohet nga prangat e robërisë ndaj çdo force djallëzore, këput çdo lidhje që, në një mënyrë apo në një tjetër, e tërheq drejt një rruge tjetër dhe refuzon çdo fuqi përveç fuqisë së Allahut, çdo sistem përveç sistemit hyjnor dhe çdo motiv që nuk është në përputhje me vullnetin e Tij. Përmes këtij mohimi të madh, ai çlirohet nga çdo formë poshtërimi, nënshtrimi, varësie dhe skllavërie.

Më pas, ai e vendos gjithë ekzistencën e tij nën urdhrin dhe vullnetin e Allahut, gjë që mund të realizohet plotësisht vetëm në kuadrin e një sistemi hyjnor, domethënë të një bashkësie islame në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kështu, ai pranon robërinë ndaj Allahut, e cila përjashton çdo formë tjetër robërie.

Ndërsa sistemet e tjera, të ndërtuara mbi bazën e mendimit njerëzor, për shkak të paditurisë, njohurive të kufizuara, devijimeve në të menduar dhe, ndonjëherë, ndikimit të interesave personale, nuk janë në gjendje ta çojnë njeriun drejt lumturisë dhe përsosmërisë së synuar.

Vetëm shoqëria dhe sistemi hyjnor mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e këtij filizi që quhet njeri. Kjo sepse ato burojnë nga urtësia dhe mëshira e Allahut, mbështeten në njohjen e plotë të nevojave njerëzore dhe kanë aftësinë t'u përgjigjen atyre. Ne nuk ushqejmë armiqësi ndaj sistemeve të tjera, por ndiejmë keqardhje për to. Ky është mesazhi i profetëve, të cilët, si baballarë të njerëzimit, ushqejnë dhembshuri dhe përkujdesje për të.

Ata u drejtohen ndërtuesve dhe arkitektëve të shtëpive ku duhet të jetojë njerëzimi, domethënë atyre që ndërtojnë sisteme dhe shoqëri, duke u bërë të qartë se njeriu nuk ka mundur dhe nuk do të mundet kurrë ta arrijë lumturinë e vërtetë, përveçse në kuadrin e një sistemi hyjnor dhe monoteist.

Historia e ka dëshmuar këtë. Ne kemi parë dhe do të vazhdojmë të shohim se çfarë vuajtjesh përjeton njeriu nën sistemet johyjnore, si është deformuar natyra e tij dhe në çfarë gjendjeje të rëndë është zhytur njerëzimi.

E katërta:

الله أكبر

"Allahu është më i Madhi."

Pas gjithë këtij mohimi, njeriu i zakonshëm, ende i lidhur me realitetet e periudhës së injorancës (xhahilijetit),

ndien njëfarë vetmie. Nga njëra anë, ai sheh me sytë e tij se si po shemben themelet që deri pak më parë i dukeshin të qëndrueshme dhe të palëkundura. Nga ana tjetër, injoranca (xhahilijeti) i pëshpërit se ajo vazhdon të qëndrojë e palëkundur si një mal.

Të njëjtat gjëra që ai i ka mohuar i shfaqen sërish si realitete dhe ia trazojnë qetësinë. Pikërisht në atë çast, ai thotë: **"Allahu është më i Madhi",** më i madh se gjithçka, më i madh se çdo njeri, më i madh se të gjitha fuqitë dhe të gjithë të fuqishmit, dhe më i lartësuar se çdo përshkrim.

Ai është Krijuesi dhe Përcaktuesi i ligjeve dhe rregullave që qeverisin universin, si në fushën e natyrës, ashtu edhe në atë të historisë. Prandaj, fitorja përfundimtare, e cila varet nga përputhja me këto ligje dhe rregulla hyjnore, mund të arrihet vetëm duke iu përmbajtur urdhrave të Tij. Bindja ndaj Allahut dhe adhurimi i Tij përbëjnë të vetmen rrugë drejt fitores në rrjedhën e historisë njerëzore.

Profeti Muhamed *(paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kuptonte shumë mirë këtë të vërtetë, besonte në të me thellësinë e shpirtit të tij dhe e përjetonte atë. Për këtë arsye, ai qëndroi i palëkundur i vetëm përballë të gjithë të devijuarve në Mekë, madje përballë gjithë botës.

Ai qëndroi me vendosmëri, ashtu siç i ka hije një njeriu të madh, duke vënë në përdorim mundësitë e tij për ta çliruar karvanin e humbur të njerëzimit nga varësia poshtëruese ndaj fuqive tiranike dhe për ta drejtuar atë drejt rrugës së natyrshme (fitres), rrugës së përsosmërisë.

Ai që ndihet i dobët dhe pa vullnet përballë fuqive njerëzore, kur kupton se fuqia më e lartë dhe më madhështore i përket Allahut të Madhëruar, gjen qetësi në zemër dhe ndien se brenda tij ndizet një forcë e veçantë, e cila e bën më të mirë dhe më të fuqishëm.

Kjo ishte, në përmbledhje, përmbajtja dhe kuptimi i katër fjalive që përsëriten gjatë qëndrimit në këmbë në rekatin e tretë dhe të katërt:

سُبْحَانَ اللهِ

"I Pastër është Allahu nga çdo mangësi."

الْحَمْدُ لِلَّهِ

"Falënderimi i takon Allahut."

لَا إِلَهَ إِلَّا اللهُ

"Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut."

اللهُ أَكْبَرُ

"Allahu është më i Madhi."

Rukuja (përkulja në namaz)

Pas përfundimit të leximit, namazfalësi hyn në ruku, domethënë përkulet para Allahut, para Fuqisë që qëndron përtej kulmit të mendimit njerëzor në horizontet e cilësive të mira dhe madhështore. Rukuja është një shembull i përuljes së njeriut para një fuqie për të cilën ai beson se është më e fortë se ai.

Meqë myslimani e sheh Allahun mbi të gjitha fuqitë, ai përkulet para Tij. Ndërsa meqë ai nuk sheh asnjë qenie tjetër përveç Allahut që të jetë më e lartë dhe më e denjë se njerëzimi i tij, ai nuk përkulet para asgjëje dhe askujt tjetër.

Në këtë gjendje, ai qëndron i përulur para Allahut, ndërsa gjuha e tij shqipton falënderime dhe madhëron Atë:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ وَبِحَمْدِهِ

***"I* Pastër dhe i Lartësuar është Zoti im i Madhëruar, dhe Atij i takon falënderimi."**[12]

[12]Është gjithashtu e mundur që ky dhikr të zëvendësohet me thënien: سُبْحَانَ اللهِ، سُبْحَانَ اللهِ، سُبْحَانَ اللهِ "I Pastër është Allahu, i Pastër është Allahu, i Pastër është Allahu."

Kjo lëvizje, e kryer në harmoni me fjalët që shqipton namazfalësi, i bën të qartë si atij, ashtu edhe kujtdo që e sheh në këtë gjendje, kuptimin e vërtetë të robërisë ndaj Allahut.

Meqenëse ai që adhuron Allahun nuk mund të jetë rob i askujt tjetër përveç Tij, kjo gjendje shpreh qartë çlirimin e tij nga çdo formë tjetër robërie.

Sexhdja (përulja me ballë në tokë)

Namazfalësi që ngre kokën nga rukuja dhe përgatitet për një përulje dhe nënshtrim edhe më të madh, ulet drejt tokës. Vendosja e ballit mbi tokë është shenjë e nivelit më të lartë të përuljes së njeriut. Namazfalësi e sheh se ky nivel i përuljes i përshtatet vetëm Allahut, sepse përulja ndaj Allahut është përulje ndaj çdo gjëje të mirë dhe ndaj bukurisë absolute.

Ai e konsideron një përulje të tillë të ndaluar dhe të palejueshme përpara kujtdo dhe çdo gjëje tjetër përveç Allahut, sepse thelbi i njeriut, që është pasuria më e çmuar në tregun e ekzistencës, shkatërrohet përmes një nënshtrimi të tillë, duke e bërë njeriun të poshtëruar dhe të thyer.

Ndërsa vendos ballin në tokë, i zhytur në madhështinë e Allahut, ai shqipton fjalë që përputhen plotësisht me këtë veprim dhe shprehin kuptimin e tij të vërtetë:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى وَبِحَمْدِهِ

"I Pastër dhe i Lartësuar është Zoti im më i Larti, dhe Atij i takon falënderimi." [13]

Allahu është më i Larti. Ai është i Pastër dhe i Shenjtëruar nga çdo mangësi. Vetëm përpara kësaj Fuqie njeriu duhet të shprehë lavdërimet e tij dhe të vendosë ballin në tokë. Prandaj, sexhdja në namaz nuk është përulje përpara një qenieje të mangët, të dobët dhe pa vlerë, siç ndodh me përuljen përpara idhujve dhe fuqive boshe. Përkundrazi, ajo është përulje dhe nënshtrim përpara Më të Lartit, Më të Pastrit dhe Më të Nderuarit.

Me këtë veprim, namazfalësi shpall në mënyrë praktike nënshtrimin e tij ndaj Allahut të Urtë dhe të Gjithëdijshëm. Dhe para së gjithash, ai ia mëson vetes këtë dorëzim dhe bindje.

Pranimi i kësaj robërie absolute ndaj Allahut, siç e kemi përmendur më parë, është pikërisht ajo që e çliron njeriun nga prangat e adhurimit të kujtdo dhe të çdo gjëje tjetër, duke e shpëtuar nga robëria dhe poshtërimi në të cilat ndodhet.

Ndikimi më i rëndësishëm që pritet nga këto dy përmendje të Allahut (dhikri i rukusë dhe ai i sexhdes) është

[13] Është gjithashtu e mundur të thuhet tri herë: سُبْحَانَ اللهِ "I Pastër është Allahu."

që t'i mësojnë namazfalësit se përpara kujt duhet të përkulet dhe të nënshtrohet.

Kjo do të thotë mohimi i çdo gjëje tjetër përveç Allahut. Ndoshta këtë kuptim e tregon edhe hadithi i transmetuar nga Imami *(paqja qoftë mbi të!):* "Gjendja kur robi është më afër Allahut është kur ai është në sexhde."[14]

Në rekatin e dytë dhe në rekatin e fundit të çdo namazi, pasi ngre kokën nga sexhdja e dytë, namazfalësi shqipton tri fjali, secila prej të cilave shpreh një të vërtetë të fesë. Ky veprim, i shoqëruar me këto fjalë, quhet "teshehud" (dëshmia).

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلٰهَ إِلَّا اللهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ

"Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, i Vetëm është Ai dhe nuk ka ortak."

Në fjalinë e parë, namazfalësi dëshmon për njëshmërinë e Zotit të botëve: "Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut."

Më pas, ai e përforcon këtë të vërtetë duke thënë: "Vetëm Ai", dhe e thekson edhe më tej me fjalët: "Nuk ka ortak për Të."

[14] "Sefinetul-Bihar", vëllimi 1, zëri: "Suxhud (سجد)".

Çdo gjë që e tërheq njeriun drejt adhurimit të saj dhe e shtyn t'i bindet, bëhet për të një "Zot", në kuptimin e ndikimit dhe të nënshtrimit. Dëshirat e tepruara, prirjet shtazore, epshet dhe shpresat njerëzore, sistemet dhe rregullat shoqërore, si dhe ata që i vendosin dhe i drejtojnë këto sisteme, secili në mënyrën e vet, e ftojnë njeriun drejt robërisë dhe drejt "hyjnizimit" të tyre.[15]

Shprehja:

لَا إِلٰهَ إِلَّا اللهُ

"Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut" është mohim i të gjitha këtyre "*zotave të rremë*".

Teshehudi është dëshmia e namazfalësit për këtë mohim. Me këtë dëshmi, ai pranon se vetëm Allahu ka të drejtën të urdhërojë dhe të sundojë mbi të, i nënshtrohet këtij autoriteti hyjnor dhe pohon se askush dhe asgjë tjetër përveç Tij nuk ka autoritet absolut mbi të.

[15] Këtu i referohet ajeteve të tilla si**: "A e ke parë atë që dëshirën e vet e ka marrë për zot?"** (Sure "El-Xhathije", ajeti 23). Dhe: **"Ata nuk u urdhëruan për asgjë tjetër, përveçse të adhurojnë një Zot të Vetëm."** (Sure "Et-Teube", ajeti 31). Dhe: "Ata i morën dijetarët dhe murgjit e tyre për zota përveç Allahut." (Sure "Et-Teube", ajeti 31). Dhe: **"Faraoni tha: O paria ime, unë nuk di që ju të keni ndonjë zot tjetër përveç meje."** (Sure "El-Kasas", ajeti 38). Si dhe transmetime të tilla si: "Zotat e tyre janë barkun e tyre." (domethënë, ata adhuruan epshet, dëshirat dhe interesat e tyre duke iu nënshtruar atyre).

Kur njeriu beson në këtë të vërtetë, ai nuk ka të drejtë të adhurojë askënd dhe asgjë tjetër përveç Allahut, qoftë njeri, kafshë, engjëll, send i pajetë, dëshirë apo pasion i brendshëm.

Kjo nuk do të thotë se monoteisti nuk i nënshtrohet asnjë përgjegjësie në shoqëri apo se nuk pranon asnjë ligj. Është e qartë se jeta shoqërore, për nga vetë natyra e saj, kërkon përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e rregullave.

Por kjo do të thotë se ai nuk pranon asnjë sundim apo sistem që nuk buron nga urdhrat e Allahut. Në jetën e tij shoqërore, ai u bindet urdhrave të Allahut. Shpeshherë, mënyra e organizimit dhe e drejtimit të jetës njerëzore, ashtu siç e dëshiron Allahu, kërkon që njeriu t'u bindet personave të caktuar dhe të marrë përsipër përgjegjësi të caktuara.

Prandaj, përmbushja e detyrimeve dhe marrja përsipër e përgjegjësive, që burojnë nga nevojat e natyrshme të jetës shoqërore, janë pjesë e pandashme edhe e jetës së njeriut monoteist.

Por kjo bindje nuk është bindje ndaj dëshirave personale, zbukurimeve të kësaj bote apo egoizmit të njerëzve të tjerë si ai. Përkundrazi, ajo është bindje ndaj urdhrit të Allahut të Urtë dhe të Gjithëdijshëm, sepse është Ai që përcakton rregullat që duhen zbatuar dhe udhëheqësit të cilëve duhet t'u bindemi. Këta të fundit kanë autoritet mbi

njerëzit vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga urdhrat hyjnorë.

Ky urdhër i Allahut i referohet pikërisht këtij realiteti:[16]

﴿وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ﴾

"Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që kanë autoritet prej jush."

Ndoshta pikërisht për të vërejtur këtë të vërtetë dhe për ta ndjekur atë, namazfalësi thotë në fjalinë e dytë të teshehudit:

وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّداً عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

"Dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij."

Pranimi i Muhamedit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si të Dërguar të Allahut është, në të vërtetë, pranimi i udhëheqjes hyjnore. Kjo do të

[16] Shqyrtimi i kujdesshëm i këtyre ajeteve dhe transmetimeve, si: **"Kush i bindet të Dërguarit, në të vërtetë i është bindur Allahut."** (Sure "En-Nisa", ajeti 80) Dhe: **"Me të vërtetë, kujdestari dhe udhëheqësi juaj është vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe ata që besuan, të cilët falin namazin dhe japin zekatin duke qenë në ruku."** (Sure "El-Maide", ajeti 55). Si dhe transmetime të tilla*: "Shikoni atë prej jush që ka transmetuar hadithet tona dhe ka vështruar (thelluar në to) …"*, dhe: "Dijetarët janë besnikët e Allahut ndaj krijesave të Tij…" mund të sqarojnë kufijtë e përafërt të kësaj të vërtete.

thotë të ndjekësh rrugën e Allahut përmes ndjekjes së rrugës së Muhamedit dhe të marrësh urdhrat e Tij përmes robit të Tij të zgjedhur.

Shumë prej robërve të Allahut kanë gabuar në njohjen e rrugës që e kënaq Atë. Njohja e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe pranimi i tij si i Dërguar i Allahut përcaktojnë dhe orientojnë përpjekjet dhe veprimet që duhet të ndërmarrë njeriu adhurues për të vërtetuar pohimin e tij se e adhuron Allahun.

Theksimi i robërisë së Muhamedit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndaj Allahut në këtë fjali, si dhe vendosja e shprehjes "robi i Tij" (عَبْدُهُ) përpara shprehjes "i Dërguari i Tij" (رَسُولُهُ), mund të jenë bërë për të nxjerrë në pah virtytin më të madh në Islam.

Dhe, me të vërtetë, kështu është. Të gjitha virtytet njerëzore përmblidhen në adhurimin e vërtetë të Allahut dhe në sinqeritetin ndaj Tij. Kushdo që ka arritur një shkallë më të lartë se të tjerët në këtë drejtim, do të ketë një peshë më të madhe në peshoren e vlerave njerëzore.

Për atë që e njeh domethënien e "*adhurimit të Allahut*", ky kuptim nuk ka nevojë për argumentim. Nëse adhurimi i Allahut nënkupton përuljen përpara urtësisë, dijes, mëshirës, mirësisë dhe bukurisë së pafundme, si dhe

çlirimin nga adhurimi i vetes dhe nga robëria ndaj të tjerëve, atëherë çfarë vlere më të lartë mund të ketë se kjo?

A nuk janë të gjitha të këqijat, poshtërimi, mjerimi, humbja e dinjitetit dhe mungesa e burrërisë, me pak fjalë, gjithçka e errët në jetën e njeriut, rezultat i robërisë së tij ndaj dëshirave të pakontrolluara të vetes ose ndaj tiranisë dhe arrogancës së atyre që pretendojnë pushtet mbi të tjerët? A nuk e djeg dhe e shkatërron adhurimi i Allahut rrënjën e çdo robërie tjetër?

Kuptimi i hollë që qëndron në këto dy fjali të teshehudit është përkujtimi i Teuhidit (njëshmërisë së Allahut) dhe i Profetësisë, përmes dëshmisë së namazfalësit për njëshmërinë e Allahut, për profetësinë e Muhamedit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për robërinë e tij ndaj Allahut. Kjo dëshmi është, në të vërtetë, pranimi i të gjitha përgjegjësive që burojnë nga këto dy besime.

Përmes këtyre dy dëshmive, namazfalësi thotë: "*Unë i nënshtrohem të gjitha detyrimeve që burojnë nga këto dy besime (Teuhidi dhe Profetësia).*"

Në Islam, nuk ka vlerë një dije e zbrazët dhe e pafrytshme, e cila nuk sjell përgjegjësi, dhe as një besim që nuk shoqërohet me veprim.

Të dëshmosh për një të vërtetë do të thotë të qëndrosh i palëkundur në të dhe të pranosh të gjitha

përgjegjësitë dhe detyrimet që burojnë nga njohja e saj. Kjo dëshmi është një pranim që lind nga besimi i pastër dhe nga një bindje aktive e pozitive. Prandaj, teshehudi i namazit është, në të vërtetë, një ripërtëritje e besëlidhjes së namazfalësit me Allahun dhe me të Dërguarin e Tij.

Fjalia e tretë e teshehudit përmban një kërkesë dhe një lutje:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَآلِ مُحَمَّدٍ

"O Allah, dërgo bekimet e Tua mbi Muhamedin dhe familjen e Muhamedit."

Profeti Muhamed dhe familja e tij e pastër *(paqja qoftë mbi ta!)* janë shenjat më të dallueshme të kësaj feje. Namazfalësi i përmend këta njerëz të mëdhenj me gjuhën e lutjes dhe, duke dërguar salavate mbi ta, e forcon lidhjen e tij shpirtërore me ta.

Pasuesit e çdo mesazhi hyjnor, nëse nuk i mbajnë përpara syve udhëheqësit e vërtetë të besimit të tyre, rrezikojnë të humbasin rrugën. Pikërisht paraqitja e shembujve të vërtetë ka forcuar qëndrueshmërinë e besimit të profetëve gjatë gjithë historisë.

Historia përmend shumë mendimtarë që kanë hartuar plane dhe metoda për të siguruar një jetë më të mirë, e cila do t'i sillte lumturi njeriut. Ata kanë përshkruar qytete ideale dhe kanë lënë pas libra e vepra të shkruara. Por

profetët, në vend që të mjaftoheshin me kërkime filozofike, i mishëruan idetë e tyre në praktikë. Ata e shndërruan veten dhe besimtarët e tyre të parë në modele për t'u ndjekur dhe, mbi supet e tyre, ndërtuan sistemin që synonin.

Për këtë arsye, rruga e profetëve mbeti e gjallë, ndërsa nga planet e filozofëve dhe mendimtarëve nuk mbeti veçse bojë mbi letër.

Namazfalësi lutet nga thellësia e zemrës së tij për Muhamedin dhe familjen e tij *(paqja qoftë mbi ta!)*, të cilët janë përmbledhja dhe mishërimi i kësaj doktrine. Ai lutet për ata që e shkrinë jetën e tyre dhe jetuan duke e mishëruar këtë besim, duke i treguar historisë një model të njeriut islam. Ai i kërkon Allahut që të dërgojë mëshirën dhe bekimet e Tij mbi ta, dhe kështu e thellon dhe e forcon lidhjen shpirtërore ndërmjet tij dhe tyre, sepse ata mund të jenë si një forcë e fuqishme tërheqëse që e afron atë drejt rrugës së tyre dhe drejt qëllimit që ata kërkonin.

Salavati për Profetin Muhamed dhe familjen e Muhamedit *(paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është ai që i bën të pranishëm figurat e njerëzve të sinqertë dhe elitës së ymetit mysliman. Duke i pasur këto figura para syve dhe duke i bërë modele për veten, myslimani mundet gjithmonë të njohë rrugën që duhet të përshkojë dhe të përgatitet për ta ndjekur atë.

Në përfundim të namazit, namazfalësi shqipton tri selam (përshëndetje), të cilat shoqërohen me përmendjen e Allahut. Kështu, namazi fillon dhe përfundon me emrin e Tij, ndërsa e gjithë rrjedha e tij, nga fillimi deri në fund, përshkohet nga përmendja e Allahut.

Edhe përmendja e Profetit ose e familjes së tij shoqërohet me përmendjen e Allahut, si një kërkim ndihme përmes mirësisë dhe mëshirës së Tij.

Fjalia e parë është një përshëndetje nga namazfalësi për të Dërguarin *(paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe një kërkesë prej Allahut për mëshirë ndaj atij robi të zgjedhur:

السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

"Paqja qoftë mbi ty, o Profet, dhe mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij!"

Profeti, themeluesi i Islamit, është prijësi i lëvizjes dhe i përpjekjeve në të cilat namazfalësi përgatitet të marrë pjesë. Është ai që ngriti thirrjen e Teuhidit (njëshmërisë së Allahut), jehona e së cilës tronditi botën dhe hodhi themelet e një jete më të mirë për njerëzimin, për të gjitha kohërat. Është ai që përcaktoi linjat kryesore të modelit islam të njeriut dhe të shoqërisë që do të shërbente si mjedis për formimin dhe zhvillimin e tij.

Namazfalësi e pasqyron këtë thirrje në namazin e tij, dhe mësimet e saj të brendshme në jetën dhe kohën e tij. Ai ecën hap pas hapi drejt asaj shoqërie më të mirë dhe drejt formimit të atij njeriu shembullor.

Prandaj, nuk është rastësi që në fund të namazit ai e përshëndet me selam të Dërguarin dhe udhërrëfyesin e tij, të cilin e ka zgjedhur si prijës në këtë rrugë. Përmes kësaj përshëndetjeje, ai shpall se qëndron përkrah tij dhe ndjek rrugën e tij.

Në fjalinë e dytë, namazfalësi i drejton përshëndetjen e paqes vetes, të gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij dhe robërve të mirë të Allahut:

السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللهِ الصَّالِحِينَ

"Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e devotshëm të Allahut!"

Në këtë mënyrë, ai e mban të gjallë në mendjen e tij kujtimin e robërve të mirë të Allahut dhe e shndërron ekzistencën dhe praninë e tyre në një burim qetësie shpirtërore.

Në një botë ku janë përhapur shfaqjet e mosbindjes, veprat e shëmtuara, poshtërsia, armiqësia dhe padrejtësia; ku pranohet ndotja morale dhe shpërfillet pastërtia; ku njeriu i arsyeshëm sheh përreth tij shenja që paralajmërojnë rrënimin e njerëzimit dhe ku shkëlqimi i jashtëm i kësaj bote

nuk është veçse një zbukurim pa përmbajtje, pas të cilit fshihen banaliteti dhe marrëzitë; në një botë ku ata që pretendojnë se mbrojnë të vërtetën dhe drejtësinë nuk arrijnë t'i fshehin shfaqjet e turpshme të egoizmit dhe të etjes për pozitë, ndërsa zhurma mashtruese e njerëzve si Muavija, Jezidi dhe Mensuri nuk mund ta errësojë pozitën e Aliut, Husejnit dhe Sadikut (paqja qoftë mbi ta!), lind natyrshëm pyetja:

Në një epokë kur ndihmësit e shejtanit kanë zënë vendin e robërve të mirë të Allahut, a mund të presim prej tyre mirësi dhe drejtësi? A mund të shpresojmë se do të gjejmë tek ata cilësitë që karakterizojnë robërit e mirë të Allahut? A mund të shohim tek ata diçka tjetër përveç mëkateve, veprave të këqija, devijimit dhe shuarjes së së vërtetës mes njerëzve? Duhet ta pranojmë se, edhe nëse kjo do të ishte e mundur, nuk do të ishte aspak e lehtë.

Në mes të kësaj gjendjeje, përshëndetja e paqes drejtuar robërve të mirë të Allahut sjell ngrohtësi dhe qetësi në zemra përmes pranisë së dritës dhe shkëlqimit. Ajo e përgëzon namazfalësin se ka ndihmës dhe shokë në këtë rrugë. Ajo i thotë: "*Ti nuk je i vetëm*", sepse edhe në zemër të kësaj shkretëtire të thatë mund të gjenden filiza frytdhënës, me rrënjë të forta. Për më tepër, gjatë gjithë historisë, shoqëritë e devijuara kanë qenë shpesh si një mitër nga e cila kanë lindur njerëz me vullnet të fuqishëm, të cilët më pas janë bërë hartuesit e një bote të re dhe kanë hedhur themelet e një jete të re.

Edhe sot, sipas ligjit të Allahut që vepron përgjatë historisë, këto forca të dritës dhe të mirësisë vazhdojnë të përpiqen dhe të veprojnë brenda kësaj bote të errët e të mbushur me të këqija.

Po, njerëzit e mirë (salihinët) e adhurojnë Allahun ashtu siç i ka hije madhështisë së Tij, i mishërojnë urdhrat e Tij në jetën e tyre dhe qëndrojnë të bashkuar përballë tiranëve.

Kush janë këta njerëz të mirë? Ku janë ata? A nuk duhet të mësojmë prej tyre dhe të ecim së bashku me ta?

Kur namazfalësi e vendos veten në mesin e tyre, ai u jep selam atyre dhe vetes me një fjali të vetme:

السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللهِ الصَّالِحِينَ

"Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e mirë të Allahut!"

Në zemrën e tij shkëlqen një dritë krenarie, nderi dhe qetësie. Ai përpiqet të jetë vërtet njëri prej tyre dhe ndien turp nëse nuk arrin të ecë në rrugën e tyre. Kjo përshëndetje e ngarkon me një zotim dhe një përgjegjësi të re.

Si janë robërit e mirë të Allahut? Në çfarë qëndron mirësia e tyre? Mirësia nuk qëndron vetëm në faljen e namazit. Ajo qëndron në aftësinë e njeriut për të mbajtur përgjegjësitë e rënda hyjnore dhe për të vepruar në mënyrë të tillë që të meritojë vërtet emërtimin "rob i Allahut", ashtu

si një nxënës që, falë përpjekjeve dhe arritjeve të tij, meriton të quhet i shkëlqyer në klasën e vet.

Në fund, falësi i namazit, në fjalinë e tretë, u drejtohet këtyre robëve të mirë, ose, siç është përmendur, engjëjve[17], ose vetë falësve të namazit dhe thotë:

السَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

"Paqja qoftë mbi ju, mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij!"

Në këtë mënyrë, ai kujton edhe një herë mirësinë dhe denjësinë për të përvetësuar cilësitë engjëllore, ose lidhjen e tij me namazfalësit e tjerë. Ai u drejton atyre që përshëndet një lutje për mirësi dhe kështu e përfundon namazin e tij.

Dhe falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

[17]Sikur të jetë në kuptimin e një mësimi për përvetësimin e cilësive të engjëjve.

إسم الكتاب: من أعماق الصلاة – الإمام الخامنئي (رضوان الله عليه)

:الاعدادإعداد :المركز العالمي للمعلومات لأهل البيت (عليهم السلام) - قم المقدسة

المترجم :الحاج الشيخ ولنت)عباس (مريا

التصحيح الادبي: سونيلا كاظمي

التصحيح اللغوى :إسراء مريا

الإخراج النهائي :صربيه فزا

الغلاف :صربيه فزا

الناشر :جمعية النسيم

تيرانا- البانيا -2026